



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 4749 /2018
Data: 12.06.2018

**PROCESVERBALI
I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA**

Nga mbledhja e tretë -III- për vitin 2018 e Komitetit për Politik dhe Financa, mbajtur me datë 22.05.2018 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e takimeve. Të pranishëm ishin: Rufki Suma (Kryetar i Komunës), Menduh Vlashi (Drejtor për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport), Zaim Bela (Drejtor për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural), Nexhmedin Daci (Drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrotjtje të Mjedisit), Fari Kalisi (Drejtor për Administratë), Sevime Laçi (Drejtoresh për Zhvillim Ekonomik), Shabi Rexhallari (Drejtor për Buxhet dhe Financa), Medina Imishti (Drejtoresh për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), Refet Kalisi (Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergjencë), Bajrush Laçi (Shef i Zyrës Ligjore), Irfan Suma (Asistent i Kryesuesit të Kuvendit të Komunës). Kryesuesi pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të KPF-së, konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Komitetit për Politik dhe Financa.

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Shqyrtimi i informatës mbi mbrojtjen e mjedisit.
3. Shqyrtimi i propozim vendimit për ndarjen e mjeteve financiare për javën kulturore 2018.

Kryesuesi thekson:- lidhur me rendin e punës hapi diskutim, nëse nuk ka e hedhë në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri, (prezent ishin të gjithë anëtarët e komitetit për politik dhe financa).

MIRATOHET RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutim, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i ishte njëzëri, (prezent ishin të gjithë anëtarët e komitetit për politik dhe financa).

MIRATOHET PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Shqyrtimi i informatës mbi mbrojtjen e mjedisit.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Nexhmedin Daci thekson:- është përgatitur informata për mjesdit për vitin 2017 edhe pse sigurimi i të dhënavë ka qenë shumë i vështirë. Agjensioni i Ministrisë për mbrojtje të mjedisit i raporton do të dhëna por nuk janë edhe aq të sakta. Në informatë i kemi paraqitur të dhënat nga stacioni i monitorimit që është i vendosur te shkolla fillore "Ilac Thaq" dhe të dhënat të cilat i kemi marr nga kompania "Sharrcem". Kemi paraqitur aktivitete e komunës të cilat ndërlidhen me mjesdin. Kemi paraqitur investimet e kompanisë "Sharrcem". Materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

Akif Shkreta thekson:- nga kjo informatë që është përcjellë del se ne nuk jemi një zonë e ndotur sepse përshkrimi që ishte bërë në këtë informatë del se nuk jemi zonë e ndotur që shpesh jemi krahasuar me Obiliqin. Edhe pse është bërë një krahasim i tillë nuk na kanë futur si komunë ndotur. Vetëm Hani i Elezit ka mbetur jashtë dhe pretendohet se është zonë e ndotur, kurse komunë e Obiliqit e ka fituar statusin prej qeverisë si komunë e ndotur e ka benefacione dhe rritje buxhetore , ndërsa Hani i Elezit jo. Si komunë jemi zonë e ndotur apo nuk jemi zonë e ndotur dhe nëse jemi zonë e ndotur duhet të jemi pjesë e atyre benificacioneve nga Qeveria sikur se komuna e Obiliqit. Nëse nuk jemi zonë e ndotur duhet të sensibilizohen edhe qytetarët që nuk është zonë e ndotur Hani i Elezit.

Mehmet Ballazhi thekson:- kjo është një informatë e viti 2017 kurse tash jemi në muajin e pestë të vitit 2018 dhe është mirë të bëhet një krahasim për tre mujorin e këtij viti me tre mujorin e viti të kaluar. Në media ka qenë çështja e azbestit dhe e nënkupton që jemi zonë e ndotur sepse ka mbetjet e azbestçimentos. Janë duke u zhvilluar punimet e kompanisë “Bektelenka” dhe nuk e di sa janë marr masa për çështjen e ndotjes së ambientit. Më mirë do të ishte të bëhet vlerësimi në periudha të caktuar se sa një vjetore për shkak se është një periudhë e gjatë në mënyrë që me u vërejtur se cilët janë faktorët më ndotës dhe cilat janë mundësit për me i evitar. Ndotje në Han të Elezit ka edhe në ajër dhe e kemi diskutuar edhe për matësin e ndotjes së ajrit që është i vendosur te shkolla fillore “Ilaç Thaçi” sepse nuk e dimë sa është i përshtatshëm dhe do të ishte mirë që me vendosur me ndonjë vend ku frekuenton ajri i ndotur sepse është larg kompanisë “Sharrcem”.

Nora Ballazhi thekson:- informata është për vitin e kaluar dhe mendoj që një informatë për ndotjen duhet të bëhet në këtë kohë sepse ndotja është më madhe në këtë kohë në krahasim me sezoinin e dimrit.

Nexhmedin Daci thekson:- askund në raport nuk shënon që nuk ka ndotje dhe ndotësit janë përmendur. Kompania “Sharcem” ka bërë investime dhe e ka ndalë pluhurin te mulliri i çimentos e nuk do të thotë se nuk ka pluhur për shkak se problemi më i madh është te halla e klinkerit. Vitin e kaluar është dashur me mbyllë në dy anët, mirëpo sipas informatave që kam i kanë filluar procedurat e tenderimit dhe në momentin që do të mbillet salla e klinkerit ndalet edhe një pikë e cila ka bërë pluhur por prapë ka me pas pluhur për shkak se vetëm transporti i çimentos që bëhet se afër 26 000 kamionë në vit që vijën këtu shkaktojnë pluhur. Sa i përket krahasimit të rezultateve e kemi stacionin e monitorimit dhe të dhënrat merren me uesbi dy herë në muaj nga përfaqësuesit e monitorimit dhe rezultatet nuk shpallen në kohë reale , mirëpo edhe pse janë të obliguar me i publikuar raportet në vëbsajd asnjë raport mujor deri më tanë nuk e kanë publikuar. Komuna të dhënët i merr prej vëbsajdit dhe për muajin janar, shkurt, mars nuk kemi rezultate dhe është problem me bërë. Vetëm komuna e Obiliqit e ka të lidhur drejtë për drejtë softuerin me agjensionin për mbrojtjen e mjesdit dhe në kohë reale i marrin të dhënët. Vend ndodhja e stacionit për mendimin tim nuk është pozitë e mirë por me udhëzim nuk është e preferueshme që stacioni me qenë afër një ndotësi siç është kompania “Sharrcem” sepse vetëm ndikimin e kompanisë “Sharrcem” mundemi me matë e jo edhe ndotësit e tjera.

Mehmet Ballazhi thekson:- ndotja nuk është vetëm prej pluhurit dhe prej gazrave por është edhe prej baltës, ujërave atmosferike, ujërave të zeza, prej ndërrimit të vajrave motorike të gjitha këta janë ndotje mos të merret vetëm ajo se veç kompania “Sharrcem” bënë ndotje ambientit. Është mirë të bisedohet edhe me QKMF për infeksionet të cilat bëhen ndoshta mund të jetë si faktorë ndotja e ajrit . Është mirë të bëhen krahasime që me bërë përpjekje për me i zvogëluar këto pasoja.

Nexhmedin Daci thekson:- për mendimin tim ndotësi më i madh për këtë vit është “Bektellenka” por këtu është përgatitur informata për vitin 2017.

Rufki Suma thekson:- pavarësish raporteve që dalin ndotje ka dhe nëse bazohemi në raporte të Ministrisë dhe kompanisë "Sharrcem" del gjithë çka në rregull. Vërejtje kam dhënë në Ministri se këto raporte janë të programuara që vetëm për me konstatuar që është gjithçka mirë. Në atë kohë kur është vendosur stacioni i monitorimit të ajrit te shkolla fillore më është dukur se është me prapavijë dhe është në ndikimin e kompanisë "Sharrcem". Është vendosë nga komisioni evropian dhe në atë kohë kanë potencuar që informatat i merr drejtë përdrejtë prej Ministrisë dhe bisedat ishin që një qasje me ja lënë edhe komunës. Çdo herë që kemi biseduar me përfaqësuesit e kompanisë kam potencuar që ju zyrtarisht e tregoni që nuk ka ndotje, mirëpo ju kam sugjeruar që ta marrin një veturnë të pastër me vendosur te komuna dhe të nesërmen shikone dhe nëse mundeni me pastruar pa ufull atëherë themi që ndotje nuk ka. Inspektorja e komunës vazhdmishtë i ka dërguar vërejtje dhe Ministria potencon që komuna nuk ka të drejtë me i shqiptuar gjobë kompanisë "Sharrcem" dhe këtë të drejtë e ka Ministria por ato asnë herë nuk i kanë shqiptuar gjobë. Kompanisë "Bektelekna" disa herë i kemi vërejtje dhe dënlime i ka shqiptuar polica për ndotje dhe për automjetet pa leje që dalin.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i ishte njëzëri, (prezent ishin të gjithë anëtarët e komitetit për politik dhe financa).

U VOTUA INFORMATA MBI MBROJTJEN E MJEDISIT QË TË PËRCILLET PËR KUVEND.

3. Shqyrtimi i propozim vendimit për ndarjen e mjeteve financiare për javën kulturore 2018.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Menduh Vlashi thekson:- shuma e mjeteve financiare dhe aktivitet janë të ngjashjshme si çdo vit edhe pse ndoshta mund të ketë ndryshime kjo agjendë për arsy se nesër kemi mbledhje me këshillin organizativ. Materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

Mehmet Ballazhi thekson:- në propozim vendim shihen të planifikuara mjete financiare ftesa për mysafirë dhe më poshtë te faqja e fundit keni përsëri ftesa dhe darkë për mysafirë. A keni paraparë mjete të planifikuara në përgjithësi për kulturë te buxheti vjetorë apo hynë në kuadër të këtij buxheti apo është veç. Çështja e sigurisë a është paraparë sepse krosi do të jetë nga komuna deri te kufiri por është problem për shkak të zhvillimit të punimeve.

Menduh Vlashi thekson:-nga viti i kaluar kemi bërë një aktivitet tradicionalë orën poetike dhe është planifikuar që me bërë ftesa për poetë, por jemi dakorduar që me anë të fesbukut me i bërë. Nuk kemi buxhet të ndarë vetëm për kulturë por kjo merret te mallrat dhe shërbimet. Për kulturë dhe sport me ligj financimi bëhet vetëm prej subvencioneve. Çështjen e sigurisë do ta diskutojmë me këshillin organizativ për çështjen e krosit.

Akif Shkreta thekson:- nga aktivitete shihet që është një gjithë përfshirje dhe me këtë shumë që do të ndahan mjetet do të shfrytëzohen për shumë kategori. Vërehet që është një agjendë më e ngjeshur. Në faqe tre dhe tetë është një gabim teknik dhe duhet të përmirësohen.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i ishte njëzëri, (prezent ishin të gjithë anëtarët e komitetit për politik dhe financa).

U VOTUA PROPOZIM VENDIMI PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR JAVËN KULTURORE QË TË PËRCILLET PËR KUVEND.

Mbledhja përfundoi në ora 11:47 ju faleminderit për pjesëmarrje

Procesmbajtësi

Avni Bushi

Kryesuesi i Kuvendit
MSc. Qamush Brava

